



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

Lënda: Përcjellje për kompetencë

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është përcjellë kërkesa për informacion e {...}, regjistruar me numër rendor 41 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 4549 prot., datë 23.09.2024, në të cilën ka parashtruar kërkesë për informacion lidhur me çështjet e mëposhtme:

1. Statistika për numrin e çështjeve civile me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar – 1 Shtator 2024, të ndara sipas neneve 617 “Publikimet mashtruese ose të pasakta”, 625 “Përgjegjësia për dëmin jopasuror”, 647/a të Kodit Civil.
2. Statistika për numrin e çështjeve penale me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar – 1 Shtator 2024, të ndara sipas neneve 119 “Fyerja”, 120 “Shpifja”, 121 “Ndërhyrje të padrejta në jetën private”, 143/b “Mashtrimi kompjuterik”, 186/a “Falsifikim kompjuterik”, të Kodit Penal.
3. Vendimmarrja përkatëse për këto çështje: vendime dënimi, pafajësie, pushimi, pranim apo rrëzim padie.
4. Informacion mbi numrin e çështjeve të reja për vitin 2024 dhe informacion për sa çështje janë të mbartura.
5. Informacion mbi faktin nëse disponohet një regjistër të dhënash mbi gazetarët dhe punonjësit e mediave ku regjistrohen rastet e padive/çështjeve ndaj tyre.

Për sa më sipër, në kushtet kur informacioni i kërkuar nuk administrohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, por nga vetë gjykatat, bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ju përcjellim për trajtim kërkesën për informacion të {...}.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, bashkëlidhur gjeni një kopje të shkresës nr. 4549 prot., datë 23.09.2024.